



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2025/0341**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare Isa Hasani Anetar dhe Vedat Poterqoi Anetar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Diamanti SH.P.K. kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues “Kompania Rajonale e Ujesjellesit Gjakova SH.A.” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Instalimi i ujësjellësit Gjakova III për fshatrat Lugbunar, Osek Hile dhe Skivjan te Komunës se Gjakovës” me numër të prokurimit: KRUGJA-24-9965-5-1-1, me 21/07/2025, mori:

### Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik Diamanti SH.P.K. e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 06/05/2025 (me numër protokollit 0341/2025) lidhur me aktivitetin e prokurimit Instalimi i ujësjellësit Gjakova III për fshatrat Lugbunar, Osek Hile dhe Skivjan te Komunës se Gjakovës me numër të prokurimit KRUGJA-24-9965-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Kompania Rajonale e Ujesjellesit Gjakova SH.A.

2. Të Anulohet, B58 Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim të aktivitetit te prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit Instalimi i ujësjellësit Gjakova III për fshatrat Lugbunar, Osek Hile dhe Skivjan te Komunës se Gjakovës me numër të prokurimit KRUGJA-24-9965-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Kompania Rajonale e Ujesjellesit Gjakova SH.A. ndërkaq aktiviteti i prokurimit i lartë përmendur kthehet në rivlerësim.

3. Kjo ankesë konsiderohet si çështje e gjykuar (res judicata) pasi që pretendimet ankimore në këtë ankesë janë të njëjta si në Vendimin PSH 2024/1264 ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, andaj ky rast konsiderohet si çështje e gjykuar “**Res Judicata**”.

4. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohet, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### Arsyetim

- *Faktet dhe rrethanat procedurale* -

Me datën: 06/05/2025, OE Diamanti SH.P.K. ka ripërsëritur ankesën në OSHP kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit: Instalimi i ujësjellësit Gjakova III për fshatrat Lugbunar, Osek Hile dhe Skivjan të Komunës së Gjakovës me numër të prokurimit KRUGJA-24-9965-5-1-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Kompania Rajonale e Ujesjellesit Gjakova SH.A.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedura të hapur, lloji i kontratës pune, vlera e parashikuar e kontratës: 750,000.00 €.

-*Vlerësimi dhe administrimi i provave* -

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit që në pajtim nënin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 20/05/2025 ka rekomanduar që:

- Të aprovohet ankesa e OE ankues, si dhe
  - Kjo çështje sipas ekspertit është çështje e gjykuar

Përgjigje në pretendimet ankimore Diamanti SH.P.K.

Ankesa është përsëritur dhe për këtë aktivitet të prokurimit tashmë është marrë vendimi me nr. OSHP: 2024/1264, i datës 12.03.2025. Më datë 06.05.2025, Operatori Ekonomik “DIAMANTI” SH.P.K dhe ka dorëzuar një ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), si palë e pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues – Kompania Rajonale e Ujesjellesit GJAKOVA SH.A.

Në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues sqaron sa vijon: sqarojmë, se bazuar në Rregulloren Nr. 01/2020 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16 (Rastet e unifikuara) par. 2) dhe 3), janë përsëritur, pretendimet ankimore të njëjta për palët në procedurë lidhur me këto pretendime ankimore, ku objekt i kontestit dhe palët janë të njëjta, për rastet të cilat janë shqyrtuar me parë, si çështje të gjykuara “resjudikata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së, andaj nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues, pasi vendimet e PSH- OSHP nuk mund të komentohen apo interpretohen nga eksperti shqyrtues.

Bëhet me dije se lidhur me pretendimet ankimore ekziston tashmë vendimi i OSHP-së me nr. 2024/1264, i datës 12.03.2025.

Duke u bazuar në platformën elektronike po edhe në raportin e ri vlerësimit AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë si dhe ekzaminimi dhe vlerësimi i ofertave është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues, përkatësisht e Komisionit Vlerësues të caktuar nga Autoriteti Kontraktues, në përputhje me nenin 59 dhe nenin 60 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar. Komisioni Vlerësues është përgjegjës për shqyrtimin, ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të paraqitura, duke siguruar që çdo vlerësim të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe parimet e transparencës, barazisë dhe konkurrencës.

Në përputhje me nenin 130 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) është i detyrueshëm për Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues është i obliguar të zbatojë pa vonesë dhe në tërësi vendimin e OSHP-së, përndryshe, sipas nenit 131 të këtij ligji, çdo mosrespektim i tillë përbën shkelje ligjore dhe mund të sjellë pasoja disiplinore dhe administrative për personat përgjegjës.

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së si dhe të kthehet në rivlerësim.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përdërisa parashtrës të palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues sqaron se, OE ankues në ankesën e parashtruar në OSHP ka ngritë pretendime ankimore të cilat paraprakisht përmes vendimin PSH 2024/1264 janë trajtuar dhe janë konsideruar si të bazuara, dhe sipas vendimeve të OSHP-se nga AK ishte kërkuar që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim dhe të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit. Konstatimet për aprovim të pretendimeve ankimore si të bazuara janë sikur në ekspertizën me nr. 1264/2024 dhe në vendimet e Panelit Shqyrtues me nr. 1264/2024 të lëshuar me datë 12.03.2025. Meqenëse vendimet kanë rezultuar me rivlerësim, nënkupton se pretendimet

ankimore kane qenë të bazuara dhe AK ka pas për obligim që të evitoj shkeljet e konstatuara ne raport të ekspertizës dhe ne vendimet e PSH-së dhe ti korrigoj ato përmes rivlerësimit, por AK nuk ka ndryshuar rezultatin me rastin e ri-vlerësimit edhe pse në kuptim të nenit 29 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së Autoriteti Kontraktues ka pas për obligim që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të njoftoj OSHP-në lidhur me rezultatin e procesit te rivlerësimit. Bazuar në nenin 16 të Rregullores se Punës se OSHP-së nr. 01/2022 paragrafi 2, kur konstatohet se pretendimet ankimore janë të njëjta të cilat janë shqyrtuar edhe më parë nga ana e Panelit Shqyrtues çështja trajtohet si “ Res- Judicata”.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, panelit shqyrtues e vlerëson si të bazuar ankesën e OE ankues Diamanti SH.P.K.. Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, Kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”.

Andaj, paneli shqyrtues në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) dhe parimet themelore të tij, Autoriteti Kontraktues (AK) ka për detyrë të sigurojë që procesi i prokurimit të jetë efikas, transparent dhe i drejtë, duke trajtuar të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese. Kjo përfshinë edhe detyrimin për të garantuar përdorimin ekonomik dhe efektiv të fondeve publike, duke mos kontribuar dhe prolonguar këtë aktivitet të prokurimit. Përfundimisht, bazuar në sqarimet e mësipërme, rezulton për këtë panel se AK, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të nenit 59 të LPP-së

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit

-Përfundim-

Bazuar në kompetencat e OSHP-së të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP-së, Paneli Shqyrtues vuri në të tjerat e tjera dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të gjitha palëve të interesuara do të kenë të drejtë të barabartë në procedurat e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet që të diskriminoj ose dëmtoj një person tjetër në proces ose të një personi ose ndërmarrje.

OSHP niset nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon njohurinë e plotë në ushtrimet e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetin e buxhetit. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka qëndruar si në dispozitiv të vendimit të marrë, i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform ndikimit në dhe natyrës së çështjes në rastin konkret duke e konsideruar po ashtu të drejtë dhe të arsyeshme edhe lejimin e mjeteve të deponuara në emër të tarifave ankimore.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafet 1 dhe 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është

paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Kimete Gashi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A.**
- **OE - DIAMANTI SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: